

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË

TOLA INVESTMENT SH.P.K.

Sot, më 03.07.2023, **Z. Dorjan Tola**, (më poshtë referuar si “**Ortaku i Vetëm**”), vendosi mbi këtë Akt Themelimi, si më poshtë:

I. Themelimi

Z. Dorjan Tola deklaron krijimin dhe themelimin e një shoqërie shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, **TOLA INVESTMENT SH.P.K.** (më poshtë referuar si “**Shoqëria**”), në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (“**Ligji Tregtar**”). Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pakufizuar.

II. Selia e regjistruar e Shoqërisë

Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: Rruga e Durrësit, Pallati 118, Tirana 1001, Tiranë, Shqipëri.

III. Objekti

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është si vijon:

Përvetësimi i pronave me çdo mënyrë në shoqëri tregtare apo subjekte juridike, ne shoqëri ekzistuese ose që do të krijohen, veçanërisht me anë të krijim të shoqërive të reja. Investime financiare, pjesëmarrje me kontribut, sponsorizim dhe kontroll te aktivitetit drejtues te ketyre shoqërive. Administrimi i qirasë dhe veprimtarive mbështetese, me synimin për të drejtuar dhe kontrolluar aktivitetet e tyre.

5.1.1 Menaxhimin dhe kryerjen e të gjitha shërbimeve në dobi të të gjitha shoqërive të kontrolluara.

5.1.2 Ofrimi i të gjitha shërbimeve të menaxhimit të të aktiveve në emër të filialeve të tij.

5.1.3 Shërbimet e konsulencës dhe mbështetjes për individë, kompani, komunitete dhe organe të tjera publike ose private.

5.1.4 Konsulencë në fushën e strategjisë, organizimit, menaxhimit, sistemeve të informacionit, burimeve njerëzore, marketingut dhe komunikimit, nga projektimi në zbatim.

5.1.5 Shërbimi i trajnimit si dhe çdo operacion apo shërbim që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me qëllimin e korporatës.

5.1.6 Veprimtaria e ofruesit të biznesit, ndërmjetësimit dhe menaxhimit të biznesit dhe konsulencës së biznesit.

5.1.7 Kërkimi i mundësive të reja të biznesit, përgatitja e prezantimeve komerciale, negocimi i kontratave, menaxhimi i marrëdhënieve me klientët.

5.1.8 Çdo aktivitet i blerjes dhe shitjes, importit dhe eksportit të të gjitha produkteve dhe mallrave të parregulluara ushqimore ose jo-ushqimore; tregtimin dhe shpërndarjen e këtyre mallrave dhe çdo aktivitet të lidhur.

5.1.9 Shoqëria do të kryejë të gjitha transaksionet industriale, tregtare dhe financiare, të luajtshme dhe të paluajtshme që mund të lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me qëllimin e korporatës dhe me çdo qëllim të ngjashëm ose të lidhur që mund të nxisë zgjerimin ose zhvillimin e saj.

5.1.10 Shoqëria do të kryejë çdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj të aktivitetit dhe/ose që lidhet me objektin e saj.

5.1.11 Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse në Republikën e Shqipërisë dhe standardet më të mira etike.

V. Kapitali

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 10,000.00 (dhjetë mijë) Euro, i cili i shprehur me kursin e këmbimit nga Euro në Lekë, datë 03 Korrik 2023, të Bankës së Shqipërisë ku 1 (një) Euro është i barabartë me 105.71 (njëqind e pese pikë shtate nje) Lekë, Kapitali është shprehur ne Lekë në vlerën 1,057,100.00 (një milion e pesëdhjetë e shtatemije e njëqind) Lekë, i ndarë ne 1 (një) kuotë të zakonshme me vlerë 10,000.00 (dhjetë mijë) Euro, plotësisht i nënshkruar dhe i pashlyer, i zotëruar plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë:

- **Z. Dorjan Tola**, shtetas shqiptar, i lindur më 08 janar 1994 në Shupenzë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J40108005E, i cili zotëron të gjithë kapitalin e Shoqërisë të barabartë me 10,000.00 (dhjetë mijë) Euro, i përbërë nga 1 (një) kuotë të barabartë me 10,000.00 (dhjetë mijë) Euro.

VI. Administratori

Administratori i Shoqërisë është:

- **Z. Dorjan Tola**, shtetas shqiptar, i lindur më 08 janar 1994 në Shupenzë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J40108005E.

Administratori emërohet për një afat në detyrë prej 5 (pese) vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori do të veprojë pa kufizime për transaksionet e kryera nga Shoqëria.

Të gjitha detyrimet, të drejtat dhe kufizimet, janë të detajuara në Statutin e Shoqërisë.

Akti i Themelimit është hartuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare", i ndryshuar.

PËR ORTAKUN E VETËM

përfaqësuar nga

.....
DORJAN TOLA
Administrator

